



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivery	11.08.2022	viti god year	2
Organ /Rjesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SHKURTICU	4659/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.594/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.594/2022 të datës 05.07.2022 të parashtruar nga ankuesi me banim në në Komunën e Gjakovës kundër Vërejtjes me shkrim 01Nr.116/01-14603 të datës 07.06.2022 të Nënkryetarit të Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 10.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.594/2022 e datës 05.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vërejtja me shkrim me numër 01Nr.116/01-14603 e datës 07.06.2022 e shqiptuar nga Nënkryetari i Komunës së Gjakovës për ankuesin.

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Komunën e Gjakovës sipas Akt emërimit AE.Nr.01-112/01-37330 të datës 13.12.2021 në pozitën "Udhëheqës i sektorit ligjor", pranë Njesisë së Sektorit ligjor tek Zyra e Kryetarit. Me datën 07.06.2022 Nënkryetari i Komunës së Gjakovës, i ka shqiptuar ankuesit Vërejtjen me shkrim me numër 01Nr.116/01-14603, me arsyetimin se i njëjti nuk ka përfillur orarin e punës, është paraqitur me vonesë në punë sipas listës së hyrje-daljeve.

Ankuesi i pakënaqur me vërejtjen me shkrim të datës 07.06.2022, e shqiptuar nga ana e Nënkryetarit të Komunës së Gjakovës, me datën 05.07.2022, ka parashtruar ankesën me Nr.Prot:3914/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vërejtja e shqiptuar përben shkelje të dispozitave të procedurës administrative, vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 18.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Gjakovës. Komuna e Gjakovës me datën 03.08.2022 përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.07.2022 me Nr.Prot:3914/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin mjekësor të datës 07.06.2022; Komunikimet elektronike përmes telefonit të datës 07.06.2022; Certifikatën e vdekjes me numër të referencës V10513135 të datës 04.07.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 03.08.2022 nga Komuna e Gjakovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit me numër AE.Nr.01-112/01-37330 të datës 13.12.2021 së bashku me formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës; E-mailin zyrtar të datës 06.06.2022; Gjendjen lidhur me sistemin elektronik të hyrje-daljeve në punë për ankuesin për periudhën prej 06.05.2022-06.06.2022; Vërejtjen me shkrim me numër 01Nr.116/01-14603 të datës 07.06.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 07.06.2022; Kërkesën për informata zyrtare të datës 05.08.2022 nga Këshilli përmes e-mailit zyrtar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit ndërlidhur me atë se Vërejtja e shqiptuar me numër 01Nr.116/01-14603 ndaj tij me datën 07.06.2022, nuk është shqiptuar nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë-Kryetari i Komunës së Gjakovës mirëpo nga Nënkryetari i kësaj komune. Ndërlidhur me këtë ka Kolegji ka analizuar dispozitat e nenit 60 konkretisht paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në të cilin përcaktohet se: *"Me kërkesë të kryetarit, Nënkryetari i ndihmon kryetarin në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij"* dhe ka konstatuar se bazuar në shkresën zyrtare të datës 03.08.2022 të ofruar nga Komuna e Gjakovës konkretisht Njësia e Burimeve Njerëzore lidhur me përgjigjen në kërkesë për ankesën e ankuesit, në të cilën ka deklaruar se, citoj: *"Vërejtja me shkrim e datës 07.06.2022, e shqiptuar ndaj ankuesit nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, nënkryetari i komunës (i cili për dy javë e zëvendësoi kryetarin e komunës ngase ndodhej në vizitë zyrtare jashtë vendit"*, del se edhe pse ankuesi sipas pozitës të cilën e mban bazuar në përshkrimin e detyrave të punës i raporton direkt kryetarin të komunës, i njëjti në periudhën kohore kur i është shqiptuar vërejtja me shkrim ka qenë në vizitë zyrtare jashtë vendit dhe në mungesë të tij sipas nenit 60 konkretisht paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, është zëvendësuar nga nënkryetari i kësaj

komune, i cili ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë si dhe funksionet ekzekutive sikur të ishte prezent ky i fundit, andaj edhe për rastin konkret me rastin e ndërmarrjes së veprimeve ligjore lidhur me shqiptimin e vërejtjes me shkrim ndaj ankuesit, ka vepruar në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në të cilin përcaktohet se: **"2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"**, e po ashtu edhe në pajtim me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në të cilën përcaktohet se: **"2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1..."**dhe rrjedhimisht edhe pretendimi i ankuesit në këtë kontekst është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar po ashtu edhe pretendimin ankimor të ankuesit i cili deklaroi se vërejtja e shqiptuar me shkrim ndaj tij nuk i përmban elementet e detyrueshme të aktit administrative, ngase nuk përmban këshillën juridike si udhëzim për afatin lidhur me ushtrimin e ankesës dhe me këtë rast ka konstatuar se duke u bazuar në nenin 10 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në të cilin përcaktohet se: **"Për procedurën dhe vendimmarrjen e komisionit disiplinor, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative"** del se vetëm Komisioni Disiplinor ka kompetencën të nxjerrë dhe vendos me vendim lidhur me përgjegjësinë ose jo të nëpunësit civil dhe se vetëm vendimi përmban elementet e aktit administrativ siç përcaktohet me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa vërejtja me shkrim e datës 07.06.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit, nuk është akt administrativ nga e cila mund të burojnë elementet detyruese, mirëpo si e tillë është akt real që për palën konkrete krijon detyrime dhe prodhon efekt juridik ndërlidhur me natyrën që nxirret dhe se bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, askund nuk theksohet fakti se vërejtja me shkrim është akt administrativ dhe se çka duhet të përmbajë lidhur me elementet detyruese të një akti, prandaj edhe ky pretendim i ankuesit në këtë drejtim është i pa bazuar dhe jo ligjor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ndërlidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit ka analizuar Vërejtjen me shkrim 01 Nr.116/01-14603 të datës 07.06.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit, dhe ka konstatuar se e njëjta i është shqiptuar nga Nënkryetari i Komunës së Gjakovës bazuar në nenin 47 paragrafin 1 pika 1.1 dhe nenin 48 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pas pranimit të raportit mujor të vijueshmërisë se i njëjti ka bërë veprime që bien në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit publikë duke mos përfillur orarin e punës, si dhe duke u paraqitur në punë me vonesë. Ndërlidhur me situatën faktike për mungesën në punë e mbi bazën e të cilës është shqiptuar vërejtja me shkrim ndaj ankuesit, Këshilli me datën 05.08.2022 përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar informata zyrtare nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës në lidhje me atë se, citoj: **"Ankuesi me rastin e mungesës në punë për periudhën prej 06.05.2022 deri më 06.06.2022, a ka dorëzuar dëshmi në lidhje me mbulesën e mungesës në punë..."**dhe në përgjigjen e datës 05.08.2022 përmes e-mailit dhënë për Këshillin, Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës, ka deklaruar se, citoj: **"Ju informoj se Njësia**

për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës nuk posedon asnjë dëshmi të kësaj natyre ne raport me nëpunësin Sipas evidencës elektronike të pushimeve në HRMIS/SIMBNJ, nëpunësi ka shfrytëzuar në tre periudhe pushimin vjetor gjate vitit 2022 (në datat 19.04.2022-22.04.2022, 06.07.2022-08.07.2022 dhe 25.07.2022-15.08.2022), i njëjti nuk ka kërkuar e as shfrytëzuar asnjë pushim të natyrave tjera”, prandaj me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: **“Orari i punës së nëpunësve civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten”**. Ndërlidhur me vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji ka analizuar edhe listën e vijueshmërisë të siguruar nga Komuna e Gjakovës për gjendjen aktuale të hyrje-daljeve në punë nga ana e ankuesit dhe ka konstatuar se i njëjti për periudhën prej 06.05.2022 deri më 06.06.2022 (për një muaj) është paraqitur në punë vetëm në datat : 10.05.2022 në kohën lokale 15:32-dalje nga puna, 10.05.2022 në kohën lokale 08:13-hyrje në punë si dhe 06.05.2022 në kohën lokale 08:19-hyrje në punë dhe për mungesën në punë për periudhën e mbetur të këtij muaji, i njëjti nuk ka paraqitur fare dëshmi tek Zyra e burimeve njerëzore e Komunës së Gjakovës lidhur me mungesën në punë për këtë periudhë. Edhe pse ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill, si dëshmi për mungesën në punë të datës se kur i është shqiptuar vërejtja ka paraqitur si dëshmi raportin mjekësor të datës 07.06.2022 lidhur me ekzaminimin radiologjik për pacienten D.H, e po ashtu si dëshmi ka dorëzuar edhe certifikatën e vdekjes për D.H. të datës 04.07.2022, i njëjti nuk ka arrit të dëshmoj se në çfarë vije familjare është me të ndjerën D.H, ngase sipas nenit 39 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, precizohet se: **“1. I punësuar ka të drejtë të mungojë nga puna me kompensim të pagës .1.2. pesë (5) ditë në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes”**, gjë që ankuesi me asnjë fakt nuk ka arritur të dëshmoj se e ndjera D.H është në vijë të ngushtë familjare me ankuesin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me ankesën e ankuesit, ka konstatuar se Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë në rastin konkret Nënkryetari i Komunës së Gjakovës ne mungese të Kryetarit të Komunës se Gjakovës ,ka arritur të konstatoj saktë gjendjen faktike dhe juridike në lidhje me shqiptimin e masës disiplinore “vërejtje” dhe ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili thekson se: **“ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit**, sepse bazuar në konstatimet e mësipërme janë vërtetuar saktë veprimet e paligjshme të ankuesit me rastin e mungesës në punë për periudhën prej 06.05.2022 deri më 06.06.2022, gjë për të cilën me asnjë fakt nuk ka arrit të dëshmoj apo arsyetoj këto mungesa tek organi i punësimit për këtë periudhë kohore.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga

dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.594/2022, datë 10/08/2022.

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.